

Njoftim për shtyp

Tiranë, 1 Korrik, 2021

RESILIENCE në hartën e ESFRI 2021

Në 30 Qershor 2021, Forumi ESFRI përfshiu RESILIENCE në Hartën e Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor 2021. Kjo do të thotë që RESILIENCE do të zërë vendin e saj në Infrastrukturat strategjike të Kërkimit Shkencor për Zonën Europiane të Kërkimit Shkencor dhe mund të punojë në zhvillimin e mëtejshëm të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në Studimet Fetare.

Nismat e para për të ndërtuar një Infrastrukturë Kërkimore datojnë që nga viti 2016, të cilat çuan përfundimisht në nisjen e RESILIENCE në shtator 2019. RESILIENCE, që atëherë ka punuar në hartimin e një infrastrukture të qëndrueshme europiane për të gjitha studimet fetare. Ky projekt tani është provuar të jetë i pjekur dhe u vlerësua me sukses nga forumi ESFRI, duke e lejuar RESILIENCE të zërë vendin e saj në Infrastrukturat Strategjike të Kërkimit për Zonën Europiane të Kërkimit.

Karakteristikë në hartimin e infrastrukturës është se, ajo përfshin si qasje fizike, edhe dixhitale në njohuri rreth fesë. Përmes kësaj infrastrukture, akademikët që janë duke punuar në fushën e gjerë të Studimeve Fetare do të mbështeten në shumë mënyra: ata do të jenë në gjendje, ndër të tjera, të kenë më shumë burime, të rrisin aftësitë e tyre dixhitale, të marrin pjesë në projekte, të promovojnë kërkimet e tyre, dhe të ndërtojnë një rrjet profesional. Gjithashtu, profesionistë të tjerë, të tillë si ata që punojnë në galeri, biblioteka, arkiva dhe muze, politikëbërësit dhe përfaqësuesit e komuniteteve fetare mund të përfitojnë nga njohuritë e ofruara nga RESILIENCE.

Vendosja në hartën e ESFRI 2021 siguron që 13 partnerët e konsorciumit, të koordinuar nga institucioni Italian i kërkimit FSCIRE, të ndërmarrin hapin tjetër. Ky hap tjetër do të jetë zhvillimi i fazës përgatitore, siç është sigurimi i financave dhe shpërndarja e detyrave midis partnerëve. Infrastruktura e re e Kërkimit ka për qëllim të mbështesë përdoruesit e saj për të paktën 34 vjet.

Lajmi për vendimin e ESFRI u prit me shumë gëzim dhe mirënjohje nga FSCIRE dhe të gjithë partnerët e konsorciumit. Të gjitha institucionet ju janë mirënjohëse ministrive dhe delegatëve kombëtarë për mbështetjen e tyre.

Lidhur me këtë arritje, koordinatorja e projektit për "Albanian University", Dr. Genta Rexha shprehet: "Përfshirja e RESILIENCE në Hartën e Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor 2021, është një vlerësim i përpjekjeve të të gjithë partnerëve, në mënyrë të veçantë të institucionit Italian të kërkimit FSCIRE, si koordinator i saj, një nxitje për të vazhduar më tej punën për të ndërtuar një infrastrukturë të qëndrueshme të Kërkimit Shkencor në Studimet Fetare dhe për ta vënë atë në dispozicion të të interesuarve në këtë fushë".

Rreth RESILIENCE

RESILIENCE është një infrastrukturë kërkimore unike, ndërdisiplinore dhe gjallëruese për të gjitha Studimet Fetare, duke ndërtuar një platformë me performancë të lartë, duke furnizuar me mjete evoluese dhe të dhëna të mëdha (*big data*) për studiues nga të gjitha disiplinat shkencore, që përshkojnë fetë në larinë e tyre diakronike dhe sinkronike.

RESILIENCE filloi në Shtator 2019 dhe do të zgjasë dy vjet. Projekti financohet nga programi Horizon 2020 i Bashkimit Europian sipas Marrëveshjes së Grantit nr. 871127. Horizon 2020 është programi Europian i financimit për kërkime dhe inovacion në Europë.

ESFRI

ESFRI është Forumi i Strategjisë Europiane për Infrastrukturat e Kërkimit. Ai është një instrument strategjik për të zhvilluar integrimin shkencor të Europës dhe për të forcuar shtrirjen ndërkombëtare. Harta ESFRI është një instrument çelës përmes të cilës, Forumi ESFRI vendos planifikimin strategjik afatgjatë Europian për zhvillimin e Infrastrukturave Kërkimore www.esfri.eu.

Partnerët e RESILIENCE

- Albanian University UFO (AL)
- Bar-Ilan University (IL)
- École Pratique des Hautes Études (FR)
- Fondazione per le Scienze Religiose (IT)
- Institut für Angewandte Informatik (DE)
- KU Leuven (BE)
- Leibniz Institute of European History (DE)
- Sofiiski Universitet Sveti Kliment Ohridski (BG)
- Theological University of Apeldoorn (NL)
- University of Sarajevo (BIH)
- Uniwersytet Warszawski (PL)
- Volos Academy for Theological Studies (GR)
- Westfälische Wilhelms-Universität Muenster (DE)

Më shumë

Më shumë informacione gjeni në www.resilience-ri.eu dhe [RESILIENCE factsheet](#).

Personi i Kontaktit për Albanian University

Genta Rexha, Koordinatore e Projektit
Albanian University
Bulevardi "Zogu I", Tiranë, Shqipëri
Tel : +355 68 62 60 838
E-mail: genta.rexha@albanianuniversity.edu.al